



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 07.06.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 , gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/4 prot., datë 04.06.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714 prot., datë 02.06.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.  
Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, gërma “d”, **plotësuar;**

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “a”, “c”, plotësuar.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me: Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:
  - **gërma “a”**, vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitohet në ERE edhe vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, pasi vërtetimi i depozituar nuk ka të dhëna mbi tatimet.**
  - **gërma “b”**, bilanci financiar i tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria në vijim duhet të përcjellë në ERE në një format të lexueshëm, Pasqyrat Financiare të periudhave 2018 dhe 2020 dhe gjithashtu të audituara pasqyrat për të tri vitet (2018, 2019 dhe 2020), pasi referuar vlerës totale të aktiveve, si dhe të ardhurave nga veprimtaria ekonomike, rezulton se është subjekt i ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.**
  - **gërma “c”**, dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.), **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitohet në ERE letrën për mbështetje financiare nga OTP Bank në gjuhën shqipe dhe gjithashtu të shoqëruar me dokumentacion mbështetës financiar sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores, ku të shprehen qartë vlerat monetare për këtë financim.**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8,
  - **gërma “b”**, Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE të specifikuar kapitalin financiar që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, e ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**